**BASHKIA KORÇË**

# RAPORT I KONSOLIDUAR PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2018

**MAJ 2019**

# Tabela e Përmbajtes

1. Hyrje ..... 3
2. Analiza sipas buxhetit vjetor ..... 3
3. Treguesit financiarë sipas raportit të monitorimit ..... 4
4. Dokumentacioni bazë ..... 5
5. Dokumentacioni shoqërues ..... 8
Analiza e detajuar e të ardhurave për vitin 2018 ..... 14
Fondet buxhetore 2018 ..... 52
Realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 sipas funksioneve dhe institucioneve ..... 55
Transfertat specifike ..... 56
- Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi ..... 56
- Administrimi i pyjeve ..... 57
- Ujitja dhe Kullimi ..... 58
- Rrugët rurale ..... 59
- Arsimi Parashkollor ..... 59
- Arsimi Parauniversitar ..... 59
- Konviktet e Arsimi Parauniversitar ..... 60
- Bashkia ..... 61
  Shpenzime për sigurime shoqërore ..... 62
  Shpenzimet operative (mallra dhe shërbime) ..... 62
Realizimi i projekteve të Bashkisë Korçë për vitin 2018 jepet si më poshtë: ..... 65
Transferta tek organizatat dhe individët ..... 66
Realizimi i buxhetit 2018 për institucionet e varësisë ..... 82
- Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes ..... 82
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ..... 89
- Qendra e Artit dhe Kulturës ..... 93
- Klubi Shumësportësh ..... 100
- Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social" (NJMBQS) ..... 103
- Qendra Ditore ..... 104
- Qendra e Rezidenciale e Zhvillimit ..... 105
- Shtëpia e Foshnjës "Lulet e vogla" ..... 105

## 1. Hyrje

Në zbatim të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 51 "Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor", Bashkia Korçë ka përgatitur raportin e konsoliduar 2018, i cili përfshin performancën vjetore si dhe pasqyrat financiare sipas dokumentave bazë dhe shoqërues. Ky raport sillet në Këshillin Bashkiak për miratim.

## 2. Analiza sipas buxhetit vjetor

Një nga nënpikat e nenit 51 "Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor", konkretisht pika 2, thotë që raporti vjetor i konsoliduar duhet të jetë i krahasueshëm me buxhetin vjetor. Ky buxhet jepet si më poshtë:

| Programi | Plan 2018 | Fakt 2018 | Dif Plan-Fakt | % e Realizimit |
|---|---|---|---|---|
| **Planifikim, Menaxhim, Administrim** | 506,399 | 345,940 | 160,459 | 68% |
| **Pastrim, Gjelbërim, Ndriçim** | 427,102 | 324,513 | 102,589 | 76% |
| **Menaxhim Rrugor+Transporti Publik** | 274,145 | 120,277 | 153,868 | 44% |
| **Menaxhim Rrugor FZHR** | 486,170 | 433,004 | 53,166 | 89% |
| **Zhvillimi i Sportit** | 41,156 | 37,759 | 3,397 | 92% |
| **Programi i Kulturës** | 166,667 | 145,522 | 21,145 | 87% |
| **Kujdesi Social** | 6,738 | 5,492 | 1,246 | 82% |
| **Arsimi Parashkollor** | 325,100 | 270,000 | 55,100 | 83% |
| **Arsimi Parauniversitar** | 56,647 | 49,543 | 7,104 | 87% |
| **Mbrojtja nga Zjarri dhe Emergjencat Civile** | 37,105 | 27,667 | 9,438 | 75% |
| **Ujitja dhe Kullimi** | 172,760 | 92,180 | 80,580 | 53% |
| **Administrimi i Pyjeve** | 66,372 | 10,672 | 55,700 | 16% |
| **Total** | **2,566,361** | **1,862,569** | **703,792** | **73%** |

Buxheti i Bashkisë për vitin 2018 është realizuar në masën 73%. Programi i cili ka realizimin më të lartë krahasuar me programet e tjera është Zhvillimi i Sportit me 92%, duke vazhduar me Menaxhimin Rrugor FZHR me 89%, për të vijuar me Programin e Kulturës dhe me Arsimin Parauniversitar me 87%. Kurse programi me realizimin më të ulët në krahasim me të tjerët ka qenë Administrimi i Pyjeve me 16%.

## 3. Treguesit financiarë sipas raportit të monitorimit

1* Raporti i shpenzimeve të përgjithshme ndaj të ardhurave të përgjithshme:

**1,862,569/2,156,451 = 86%**

2* Raporti i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme:

**620,322/2,156,451 = 29%**

3* Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifat vendore ndaj planit të tyre:

**620,322/903,411 = 69%**

4* Raporti i shpenzimeve kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme:

**713,078/1,862,569 =38%**

5* Raporti i shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme:

**577,168/1,862,569 = 31%**

6* Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të përgjithshme:

**55,261/2,156,451 = 2.5%**

7* Raporti i huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta:

**55,261/620,322 = 9%**

9* Raporti i detyrimeve tatimore të paarkëtuara në kohë ndaj të ardhurave tatimore:

**193,377/281,308 =69%**

11* Raporti i shpenzimeve për politikat e kujdesit shoqëror ndaj shpenzimeve të përgjithshme:

**2,984/1,862,569 = 1%**

Raporti i Konsoliduar do të jetë i paraqitur në vazhdim nga dokumentacioni bazë dhe ai shoqërues.

## 4. Dokumentacioni bazë

*a) fondet buxhetore, të realizuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitin 2018, të ndara në korrente dhe kapitale*

000/lekë

| Nr | Funksionet | Institucioni | Fakt 2018 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shp. për personelin (600+601) | Shp. te tjera korrente (602-606) | Shp. për Invest (230+231) | Totali |
| 1 | Planifikim, Menaxhim, Administrim | Bashkia | 119,072 | 222,399 | 4,469 | **345,940** |
| 2 | Pastrim, Gjelbërim, Ndriçim | NSHP, Bashkia | 131,772 | 156,458 | 36,283 | **324,513** |
| 3 | Menaxhimi Rrugor+Transporti Publik | NSHP, Bashkia | 4,905 | 8,499 | 106,873 | **120,277** |
| 4 | Menaxhimi Rrugor FZHR | Bashkia | | | 433,004 | **433,004** |
| 5 | Zhvillimi i Sportit | Kl. i Futbollit dhe Kl.Shmsp. | 13,070 | 24,570 | 119 | **37,759** |
| 6 | Programi i Kulturës | Qendra e Artit dhe Kulturës | 26,966 | 42,885 | 75,671 | **145,522** |
| 7 | Kujdesi Social | NJMBQS, QRZH, QD, Shtëpia e Foshnjës | 3,393 | 1,745 | 354 | **5,492** |
| 8 | Arsimi Parashkollor | NSHMAÇ | 198,719 | 66,903 | 4,378 | **270,000** |
| 9 | Arsimi Parauniversitar | NSHMAÇ | 32,730 | 15,346 | 1,467 | **49,543** |
| 10 | Mbrojtja nga Zjarri dhe Emergjencat Civile | Bashkia, MZSH | 24,767 | 2,629 | 271 | **27,667** |
| 11 | Ujitja dhe Kullimi | NSHP | 13,562 | 29,003 | 49,615 | **92,180** |
| 12 | Administrimi i Pyjeve | Bashkia | 8,212 | 1,886 | 574 | **10,672** |
| | **Totali** | | **577,168** | **572,323** | **713,078** | **1,862,569** |

*b) tavanet për çdo program, për vitin e dytë dhe të tretë të programit buxhetor afatmesëm.*

*000/lekë*

| Tavanet sipas PBA-së | 2019 | | | | 2020 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shp.personeli | Shp.korrente | Shp.investime | Totali | Shp.personeli | Shp.korrente | Shp.investime | Totali |
| | 600+601 | 602-609,166,651 | 230+231 | | 600+601 | 602-609,166,651 | 230+231 | |
| **Planifikim, Menaxhim, Administrim** | 167,000 | 178,820 | 30,000 | 375,820 | 168,500 | 181,000 | 32,000 | 381,500 |
| **Pastrim, Gjelbërim, Ndriçim** | 178,000 | 287,000 | 42,000 | 507,000 | 179,602 | 290,000 | 43,000 | 512,602 |
| **Menaxhimi Rrugor+Transporti Publik** | 6,457 | 10,000 | 160,308 | 176,765 | 6,457 | 10,000 | 192,879 | 209,336 |
| **Menaxhimi Rrugor FZHR** | | | 500,000 | 500,000 | | | 500,000 | 500,000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Zhvillimi i Sportit** | 14,280 | 98,000 | | 112,280 | 14,566 | 99,000 | 150 | 113,716 |
| **Programi i Kulturës** | 32,000 | 54,500 | 3,500 | 90,000 | 34,000 | 55,000 | 4,500 | 93,500 |
| **Kujdesi Social** | 3,600 | 693,081 | 525 | 697,206 | 3,671 | 693,143 | 540 | 697,354 |
| **Arsimi Parashkollor** | 208,024 | 77,000 | 19,000 | 304,024 | 209,500 | 78,000 | 19,000 | 306,500 |
| **Arsimi Parauniversitar** | 35,069 | 25,475 | 1,600 | 62,144 | 37,000 | 25,950 | 1,600 | 64,550 |
| **Mbrojtja nga Zjarri dhe Emergjencat Civile** | 25,923 | 6,169 | 1,363 | 33,455 | 25,923 | 6,169 | 1,374 | 33,466 |
| **Ujitja dhe Kullimi** | 17,767 | 25,411 | | 43,178 | 17,767 | 25,411 | | 43,178 |
| **Administrimi i Pyjeve** | 11,924 | 370 | 16,448 | 28,742 | 11,924 | 370 | 16,595 | 28,889 |
| **Total** | **700,044** | **1,455,826** | **774,744** | **2,930,614** | **708,910** | **1,464,043** | **811,638** | **2,984,591** |

*c) një tabelë përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme;*

*000/lekë*

| **Të ardhurat** | **Fakt 2017** | **Fakt 2018** | **2019** | **2020** | **2021** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Të ardhurat nga taksat** | 278,597 | 297,158 | 646,363 | 588,130 | 593,423 |
| **Të ardhurat nga tarifat** | 227,726 | 279,399 | 344,368 | 347,086 | 350,056 |
| **Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera** | 1,967 | 1,909 | 20,099 | 20,280 | 20,463 |
| **Të ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme** | 14,797 | 19,384 | 32,505 | 17,576 | 17,724 |
| **Të ardhura të tjera** | 53,802 | 41,856 | 42,400 | 28,492 | 28,912 |
| **Totali A** | **576,889** | **639,706** | **1,085,735** | **1,001,564** | **1,010,578** |
| **Të ardhura të kushtëzuara (VKM)** | 40,000 | | | | |
| **Transferta e kushtëzuar** | 594,476 | 595,041 | | 574,639 | 574,639 |
| **Transferta e pakushtëzuar** | 395,385 | 419,527 | 439,016 | 460,843 | 506,481 |
| **Fondi i Zhvillimit të Rajoneve** | 1,466,674 | 486,170 | | | |
| **Të ardhurat e trashëguara** | 344,906 | 373,771 | 293,882 | | |
| **Transferta specifike** | 301,771 | 302,498 | 304,457 | 302,498 | 302,498 |
| **Sponsorizime** | 1,976 | 2,591 | | | |
| | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali B** | **3,145,188** | **2,179,598** | **1,037,355** | **1,337,980** | **1,383,618** |
| **Totali i të ardhurave** | **3,722,077** | **2,819,304** | **2,123,090** | **2,339,544** | **2,394,196** |
| **Shpenzimet** | | | | | |
| **600-601** | 557,270 | 577,168 | 633,191 | 719,663 | 738,074 |
| **602-609, 651, 166** | 482,298 | 572,323 | 886,483 | 1,319,713 | 1,336,237 |
| **230-231** | 1,534,252 | 713,078 | 603,416 | 300,168 | 319,885 |
| **Totali i shpenzimeve** | **2,573,820** | **1,862,569** | **2,123,090** | **2,339,544** | **2,394,196** |

*d) numrin e punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për vitin 2018;*

| **Emërtimi** | **Viti 2018** |
|---|---|
| | **Fakt** |
| Bashkia | 159 |
| Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi | 30 |
| Administrimi i pyjeve | 18 |
| Sherbimi i Pastrimit | 1 |
| Gjendja civile | 12 |
| QKB | 2 |
| Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes | 381 |
| Ndërmarrja e Shërbimeve Publike | 301 |
| Qendra e Artit dhe Kulturës | 45 |
| Klubi Shumësportësh | 14 |
| Klubi i Futbollit | 8 |
| Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social | 2 |
| Shtëpia e Foshnjës | 3 |
| **Total** | **976** |

*e) përputhshmërinë me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore.*

Raporti i konsoliduar i buxhetit vjetor të Bashkisë Korçë vjen në përputhje më rregullat fiskale në fuqi për vetqeverisjen vendore, rregulla mbi të cilat është hartuar dhe miratuar edhe paketa fiskale e vitit 2018. Konkretisht, në germen "f", të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i

ndryshuar, udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", udhëzimin nr.7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", në ligjin nr.9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e vetqeverisjes vendore", në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", ligjin 8519 datë 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", ligjin 10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

## 5. Dokumentacioni shoqërues

*a) Informacion të detajuar për shpenzimet, sipas klasifikimeve buxhetore;*

Bashkëngjitur raportit:

***Tabela 1**: Analiza e buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për periudhën Janar-Dhjetor 2018 nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike

***Tabela 2**: Analiza e buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për periudhën Janar-Dhjetor 2018 nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurave të institucioneve

***Tabela 5**: Plani I Buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2018, i ndryshuar ( transferta e pakushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurat e institucioneve).

*b) Listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program:*

Kjo listë jepet e detajuar përgjatë materialit.

*c) Llogaritjen e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore, si pjesë e paketës fiskale të parashikuara në këtë buxhet vjetor po i pasqyrojmë në tabelën e mëposhtme:*

*d)*

**Tabela: Llogaritja e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore**

| Taksa/tarifa | Efekti financiar |
|---|---|
| Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit | 4,416,000 |
| Tarifë servitut kalimi në pronë publike | 560,518 |
| Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore | 624,000 |
| Lejë, çertifikata apo liçenca për veprimtari (lavazh, parking, servis automjete, materiale ndërtimi, autoshkolla e.t.j) | 640,000 |
| Tarifa të inspektoriatit të ndërtimit | 117,000 |
| Përjashtim nga pagesa e tarifës së (pastrimit, ndricimit, gjelbërimit) | 277,500 |
| **Totali** | **6,635,018** |

*e) Listën e njësive shpenzuese të Bashkisë Korçë:*

- Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
- Qendra e Artit dhe Kulturës
- Klubi Shumësportësh
- Klubi i Futbollit
- Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social
- Qendra Ditore
- Qendra Rezidenciale e Zhvillimit
- Shtëpia e Foshnjës

*f) Objektivat kryesorë të programeve të Bashkisë Korçë:*

1. Nxitja e sigurimit të shërbimit cilësor.
2. Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku janë parashikuar zhvillime urbane.
3. Rrugë me cilësi të lartë dhe zhvillim urban me hapësira të reja publike.
4. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike.
5. Shtimi i elementëve plotësues të lulishteve (stola, kosha, vepra arti).
6. Futja në sisteme efiçente alternative të pëdorimit të energjisë.
7. Përmbushjen me sukses e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e arsimit.
8. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
9. Vënia në funksionim i Qendrës Multifunksionale sportive kulturore.

10. Shtimi i aktiviteteve atraktive sportive.
11. Parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja në shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut.
12. Administrimi, qeverisja dhe mbrojtja e fondit pyjor dhe kullosor kombëtar, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.
13. Krijimi i marrëdhënieve midis Bashkisë Korçë, pronarëve dhe biznesit privat për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor.
14. Të mbrojë dhe sigurojë përfituesit nga çdo lloj forme abuzimi.
15. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve.
16. Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i veprave ujitëse.

*g) Informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të Bashkië Korçë dhe një analizë të elementeve të riskut, të cilat karakterizojnë këtë borxh;*

Në buxhetin e vitit 2018 sipas planeve të amortizimit është shlyer kredia e financuar nga Ministria e Financave (CEB), Pro Credit Bank dhe Intesa San Paolo.

Realizimi i kredisë për vitin 2018 jepet si më poshtë:

**Tabela: Realizimi i kredisë për 2018**

000/lekë

| Shlyerja e kredisë 2018 | Plan 2018 | Fakt 2018 |
|---|---|---|
| Pagesë Principali | 47,600 | 46,441 |
| Interesi | 9,500 | 8,820 |
| Total | 57,100 | 55,261 |

Shlyerja e kredisë sipas bankave deri në fund të vitit 2018 jepet si më poshtë:

**Intesa Sanpaolo Bank**

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin Tetor është 49,000,000 lekë.

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin Dhjetor është 100,000,000 lekë.

Për vitin 2015 shuma e disbursuar në muajin Mars  është 50,000,000 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë është: principali në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 14,101,645.12  lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Tetor 2014- Dhjetor 2018 janë paguar principal 14,440,407.00 lekë dhe interes në vlerën  8,819,065.00 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë është: principali në vlerën 100,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 28,844,307.55 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2018 janë paguar principal 28,683,821.97 lekë dhe interes në vlerën 18,097,186.94 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: principali në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 13,579,622.88 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Mars 2015- Dhjetor 2018 janë paguar principal  13,612,159.03 lekë dhe interes në vlerën 8,315,051.06  lekë.

Kjo kredi është përdorur për rikonstruksione rrugësh dhe shpronësime me interes publik.

**Pro-Credit Bank.**

Për vitin 2010 shuma e disbursuar është 44,955,000 lekë.
Për vitin 2011 shuma e disbursuar është 23,776,200 lekë.
Për vitin 2012 shuma e disbursuar është 23,776,200 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë është: principali në vlerën 45,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 18,396,700.67  lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Tetor 2010- Dhjetor 2018 janë paguar principal në vlerën 34,828,267.13  lekë dhe interes në vlerën  17,947,581.44 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë është: principali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 9,202,450.21 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë

disbursim Qershor 2011- Dhjetor 2018 janë paguar principal në vlerën 17,027,346.63 lekë dhe interes në vlerën 8,789,347.37 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: principali në vlerën 23.800.000 lekë dhe interesi në vlerën 8,208,216.56 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim Tetor 2012- Dhjetor 2018 janë paguar principal në vlerën 13,165,841.63 lekë dhe interes në vlerën 7,254,457.61 lekë.

Përdorimi i huamarjes vendore (kredisë) për shpenzime kapitale është mbyllur gjatë vitit 2012.

**CEB.**

Transhi I 2014-2023 shuma e disbursuar është 340,214 euro

Transhi II 2016-2025 shuma e disbursuar është 640,000 euro

Transhi III 2017-2026 shuma e disbursuar është 110,000 euro

Transhi IV 2018-2027 shuma e disbursuar është 101,386 euro

Sipas planit të pagesave të transhit të parë për periudhën Dhjetor 2014- Dhjetor 2018 janë paguar principal në vlerën 23,174,489.04 lekë (170,107 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të dytë për periudhën Shtator 2016- Dhjetor 2018 janë paguar principal në vlerën 25,977,600.00 lekë (192,000 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të tretë për periudhën Korrik 2017- Dhjetor 2018 janë paguar principal në vlerën 2,907,300 lekë (22,000 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të katërt për periudhën Mars 2018- Dhjetor 2018 janë paguar principal në vlerën 1,368,711 lekë (10,138.60 euro).

Kjo hua është përdorur për ndërtimin e banesave me qëllim social.

Më poshtë përmbledhje e shlyerjes së kredisë sipas bankave deri në fund të vitit 2018:

| Emërtimi i bankës | Principal | | | Interesi | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Plani i pagesave | Shlyerja | Vlera e mbetur për tu shlyer | Plani i pagesave | Shlyerja | Vlera e mbetur për tu shlyer |
| **Intesa Sanpaolo Bank** | 200,000,000.00 | 56,736,388.00 | 143,263,612.00 | 56,525,575.55 | 35,231,303.00 | 21,294,272.55 |
| **Procredit Bank** | 92,600,000.00 | 65,021,455.39 | 27,578,544.61 | 35,807,367.44 | 33,991,386.42 | 1,815,981.02 |
| **CEB** | 166,824,000.00 | 53,428,100.04 | 113,395,899.96 | 0 | 0 | 0.00 |
| **TOTAL** | **459,424,000.00** | **175,185,943.43** | **284,238,056.57** | **92,332,942.99** | **69,222,689.42** | **23,110,253.57** |

**Elementët e riskut që e karakterizojnë këtë borxh janë:**

- ✓ Ndjekja e grafikut të përgatitur nga bankat me datat përkatëse për likuidimin e kësteve, parashikimi i fondeve për likuidimin e kësteve.
- ✓ Ndryshimi i normave të interesit në rritje.
- ✓ Sigurimi i informacionit të duhur, në kohën e duhur mbi normat e interesit, ndjekja e trendit të normës së interesit.
- ✓ Risku i kursit të këmbimit.
- ✓ Ndjekja me kujdes e raportimit, bisedime me bankën mbi kursin e këmbimit, si dhe ndjekja e trendit të kursit të këmbimit.

*h) sipas rastit, një përmbledhje të pagesave të vonuara ndaj palëve të treta, përfshirë edhe origjinën e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre.*

Detyrimet e mbartura janë në vlerën 48,732,921 lekë, të detajuar si më poshtë:

Investime - 46,475,826 lekë

Mallra dhe Shërbime - 1,447,495 lekë

Vendime gjyqësore - 809,600 lekë

Theksojmë se shlyerja e detyrimeve është prioritare gjatë kryerjes së shpenzimeve nga ana e Bashkisë Korçë.

*Bashkëngjitur raportit të konsoliduar:

**Tabela 5**: Tabela e detyrimeve të prapambetura për periudhën Janar-Dhjetor 2018 (Paraqitur dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë).

## Analiza e detajuar e të ardhurave për vitin 2018
## Tabela përmbledhëse e të ardhurave

**Tabela: Burimet e financimit dhe % për çdo zë ndaj totalit**

000/lekë

| Nr. | Burimet e financimit | Vlera në 000/lekë | % për çdo zë ndaj totalit |
|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhurat e trashëguara | 359,125 | 17% |
| 2 | Transferta e pakushtëzuar | 419,527 | 19% |
| 3 | Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore | 620,322 | 29% |
| 4 | Të ardhurat e institucioneve të varësisë | 19,234 | 1% |
| 5 | Sponsorizim QRZH | 150 | 0% |
| 6 | Kontribut i Qarkut | 2,000 | 0% |
| 7 | Sponsorizime të ndryshme | 591 | 0% |
| 8 | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve | 433,004 | 20% |
| 9 | Transferta specifike | 302,498 | 14% |
| | **Total** | **2,156,451** | **100%** |

**Tabela : Realizimi i të ardhurave nga Institucionet e Varësisë në 2018 në 000/lekë**

000/lekë

| Nr. | Emërtimi i Institucionit | Pl 2018 | Fakt 2018 | % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërmarrja e Shërbimeve Publike | 5,000 | 5,553 | 111% |
| 2 | Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes | 11,000 | 9,890 | 90% |
| 3 | Klubi Shumësportësh | 63 | 63 | 100% |
| 4 | Qendra e Artit dhe Kulturës | 3,820 | 3,707 | 97% |
| 5 | Qendra e Artit dhe Kulturës sp | 350 | 350 | 100% |
| 6 | Shtëpia e Foshnjës sp | 241 | 241 | 100% |
| 7 | Qendra Ditore e Zhvillimit | 50 | 21 | 42% |
| 8 | Qendra e Zhvillimit Rezidencial | 50 | | 0% |
| 9 | Qendra e Zhvillimit Rezidencial grand | 150 | 150 | 100% |
| | **Total** | **20,724** | **19,975** | **96%** |

Bashkia Korçë gjatë vitit 2018 ka pasur financime si më poshtë:

Për QAK në vlerë 350 mijë lekë

Për Shtëpinë e Foshnjës në vlerë 241 mijë lekë

Për QRZH në vlerën 150 mijë lekë

**Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2018**

Realizimi i të ardhurave për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Korçë për intervalin kohor 2015-2018 ka rezultuar me rritje të të ardhurave nga viti në vit si në përqindje realizimi ashtu dhe në vlera, krahasim ky i bërë duke marrë për bazë si vit krahasimor vitin 2018 me vitet paraardhëse të periudhës krahasimore.

Ndryshe nga herët e tjera kur periudha krahasimore ka qënë për një interval 5 vjecar me të cilin krahasonim progresin në administrim dhe grumbullimin e taksave dhe tarifave lokale, këtë vit intervali krahasimor do përfshijë periudhën 2015 – 2018 periudhë kjo, nga ku nisi zbatimi i reformës së re administrative – territorial, por edhe i ligjit të ri për financat vendore.

Konkretisht realizimi i të ardhurave në vitin 2018 krahasuar me realizimin e të ardhurave në vitin 2015 rezulton me një rritje prej 60.9 % ose 234,729,774 lekë më shumë, realizimi i të ardhurave në vitin 2018 krahasuar me realizimin e të ardhurave në vitin 2016 rezulton me një rritje prej 14.2 % ose 77,370,406 lekë më shumë dhe realizimi i të ardhurave në vitin 2018 krahasuar me realizimin e të ardhurave në vitin 2017 rezulton me një rritje prej 10.4 % ose 58,230,872 lekë më shumë.

Në këto realizime vlen të theksohet se ndikim ndër vite ka pasur përmirësimi i dukshëm në administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave, rritja e kapaciteteve, rritja e bazës së taksueshme, rritja e transparencës, fuqizimi i nivelit të bashkëpunimit midis drejtorive si dhe monitorimi i performancës midis institucioneve, i cili reflektohet më së miri nga të gjitha strukturat e Bashkisë.

Për ilustrim dhe paraqitje grafike po japim trendin e realizimit të të ardhurave për taksa dhe tarifa vendore për periudhën 2015 – 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| **Të ardhurat për periudhën** | **385,592,623** | **542,951,991** | **562,091,525** | **620,322,397** |




| Nr. | EMËRTIMI | Realizim 2018 | Planifikim 2018 | Në % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | TATIM FITIMI I THJESHTUAR PËR BIZNESIN E VOGËL | 5,190,961 | 32,200,000 | 16% |
| 2 | TAKSË MBI NDËRTESËN | 102,952,983 | 140,082,000 | 73% |
| 3 | TAKSË MBI TRUALLIN | 9,127,377 | 7,500,000 | 122% |
| 4 | TAKSË TABELE | 9,551,861 | 14,173,000 | 67% |
| 5 | TAKSË HOTELI | 5,059,780 | 4,200,000 | 120% |
| 6 | TAKSË NDIK.INFRAST. NGA NDËRTIMET E REJA | 59,464,396 | 230,000,000 | 26% |
| 7 | TAKSË NDIK.INFRAST.NGA LEGALIZIMET | 26,006,146 | 37,000,000 | 70% |
| 8 | TAKSË NDIK.INFRAST.MINISTRIA E ENERGJISË | 1,958,811 | 12,200,000 | 16% |
| 9 | DIVIDENTI NGA U.K.KO | 7,864,515 | 4,500,000 | 175% |
| 10 | DIVIDENTI NGA TREGU I SHUMICËS | 0 | 1,200,000 | 0% |
| 11 | RENTA MINERARE | 110,375 | 100,000 | 110% |
| 12 | TAKSE E PËRKOHSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKE | 0 | 1,800,000 | 0% |
| 13 | TATIM MBI TOKËN BUJQËSORE | 22,657,362 | 37,230,000 | 61% |
| 14 | TAKSË REGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE) | 37,623,253 | 42,500,000 | 89% |
| 15 | TATIM SHITJE PASURI E PALUAJTSHME | 9,590,732 | 13,000,000 | 74% |
| 16 | TARIFË PASTRIMI | 155,983,218 | 165,261,000 | 94% |
| 17 | TARIFË NDRIÇIMI | 37,942,813 | 41,101,667 | 92% |
| 18 | TARIFË GJELBËRIMI | 24,707,001 | 28,383,500 | 87% |
| 19 | TARIFË SERVITUTI | 486,544 | 2,000,000 | 24% |
| 20 | TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI | 1,065,480 | 3,700,000 | 29% |
| 21 | TARIFË PARKIMI | 20,666,333 | 24,000,000 | 86% |
| 22 | TARIFË MUR PERIMETRAL | 628,832 | 1,450,000 | 43% |
| 23 | TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI | 440,000 | 1,200,000 | 37% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 24 | TARIFE PER DHËNIEN NË PËRDORIM TË TUBC. NËNTOKË | 5,040 | 1,500,000 | 0% |
| 25 | TARIFË PËR ZENIE HAPESIRË PUBLIKE | 15,048,221 | 17,800,000 | 85% |
| 26 | TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA | 782,100 | 1,900,000 | 41% |
| 27 | TARIFË UJI I PIJSHËM | 129,372 | 450,000 | 29% |
| 28 | TARIFË VARREZA | 14,273,419 | 16,150,000 | 88% |
| 29 | TARIFË THERJE BAGËTI | 2,397,550 | 1,000,000 | 240% |
| 30 | TARIFË PËR LEJE NDËRTIMI | 123,000 | 450,000 | 27% |
| 31 | QIRA OBJEKTI + QIRA TRUALLI + QIRA TOKA BUJQËSORE | 1,908,587 | 19,920,000 | 10% |
| 32 | TË ARDHURA TË TJERA (vertetime,çertifikata etj.) | 4,720,333 | 12,327,000 | 38% |
| 33 | ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI | 498,400 | 500,000 | 100% |
| 34 | MIRATIM PROJEKTI | 119,000 | 300,000 | 40% |
| 35 | SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIG. | 0 | 250,000 | 0% |
| 36 | SHËRBIME ZJARRFIKSE NË BASHKI FQINJE | 0 | 300,000 | 0% |
| 37 | MARRJE ME QERA PYLLI | 13,872,624 | 10,900,000 | 127% |
| 38 | TË ARDH.NGA SHITJA E DRUVE | 3,755,676 | 5,000,000 | 75% |
| 39 | VËRTETIME TRANSPORTI | 108,000 | 100,000 | 108% |
| 40 | PRODHIME TË DYTA MEDICINALE | 289,250 | 300,000 | 96% |
| 41 | SHITJE DOKUMENTA ANKANDI | 1,000 | 1,000 | 100% |
| 42 | GJOBA POLICIA BASHKIAKE | 2,557,000 | 2,000,000 | 128% |
| 43 | GJOBË PËR VONESË NË PAGESË | 7,466,884 | 7,500,917 | 100% |
| 44 | GJOBË KOLAUDIMI MATERIALE DRUSORE | 36,200 | 0 | |
| 45 | GJOBA TË DREJT. SË KONTROLLIT TË TERRITORIT | 341,500 | 1,500,000 | 23% |
| 46 | GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT | 2,160,000 | 3,600,000 | 60% |
| 47 | GJOBA TË DREJTORISË SË TË ARDHURAVE | 60,000 | 300,000 | 20% |
| 48 | TË ARDH. NGA QIRATË, BANESA SOCIALE | 6,929,215 | 6,962,400 | 100% |
| 49 | QIRA NGA BANESAT NË PRON.TË BASHKISË, ENTI BANESAVE | 3,243,939 | 5,377,573 | 60% |
| 50 | KAMA TË VONESA (QIRA OBJEKTI ) | 417,314 | 500,000 | 83% |
| | **TOTALI** | **620,322,397** | **961,670,057** | **65%** |

## TË ARDHURA NGA TAKSAT DHE TATIMET

## TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël | 32,200,000 | 5,190,961 | 16 % |

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël në buxhetin e vitit 2018 është planifikuar 32,200,000 lekë dhe realizimi i tij deri në fund të vitit 2018 është në masën 16 % ose në vlerën 5,190,961 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve paraardhëse si taksë vendore të pa paguara nga 16 subjekte debitore në vlerën 550,396 lekë dhe nga arkëtimi i vlerës 4,640,565 lekë konkretisht nga 26 subjekte për vitin 2014 me vlerë 265,492 lekë, nga 44 subjekte për vitin 2015 me vlerë 568,078 lekë, nga 45 subjekte për vitin 2016 me vlerë 225,012 lekë, nga 119 subjekte për vitin 2017 në vlerën 3,398,342 lekë dhe nga 20 subjekte gjatë vitit 2018 në vlerën 183,641, të cilat janë derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga DRT Korçë si tatim i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël ku kjo e fundit bazuar në legjislacionin aktual në fuqi është në rolin e agjentit tatimor.

## TAKSË MBI NDËRTESËN

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 2 | Taksë mbi ndërtesën | 140,082,000 | 102,952,983 | 73 % |

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 140,082,000 lekë dhe është realizuar në masën 73% ose në vlerë 102,952,983 lekë. Vlen për tu theksuar se taksa mbi ndërtesën është një nga taksat e cila referuar ndryshimeve ligjore pësoi ndryshim si në mënyrën e taksimit ashtu dhe në vlerë. Prej muajit Prill të vitit 2018 është aplikuar një mënyrë taksimi e ndryshme nga sa subjektet, familjarët apo dhe pronarët e ndërtesave ishin taksuar deri në atë moment, pra nga taksë me bazë fikse u bë taksë e llogaritur mbi vlerën e tregut. N.q.se një subjekt i cili operon në fushën e tregëtisë apo shërbimeve dhe deri në muajin mars të vitit 2018 taksën e ndërtesës e kishte 300 lekë/ m² në njësinë administrative Korçë dhe 150 lekë/m² në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë, prej muajit prill 2018 ky subjekt paguan 137,4 lekë / m² në njësinë administrative Korçë dhe 89.5 lekë/m² në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë, po kështu një subjekt i cili operon në fushën e prodhimit dhe deri në muajin mars të vitit 2018 taksën e ndërtesës e kishte 150 lekë/ m² në njësinë administrative Korçë dhe 75 lekë/m² në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë, prej muajit prill ky subjekt paguan 45.8 lekë/m². Ndryshime pësuan dhe kategoritë e tjera të ndërtesave si ato që përdoren për banim, bodrumet, ndërtesat që përdoren për bujqësi dhe blegtori e.t.j, pra megjithëse planifikimi

për vitin 2018 ishte bërë pa u miratuar ndryshimet ligjore në lidhje me këtë taksë dhe megjithëse realizimi i kësaj takse nga subjektet tregëtare dhe prodhuese të cilat mbanin peshën kryesore në këtë planifikim priteshe të uleshe me gati 1/3 e realizimeve ndër vite, falë punës, zbatimit rigoroz të masave shtrënguese, shkëmbimit të informacionit ndërmjet zyrave të Bashkisë apo dhe institucioneve ne mundëm të realizojmë 73 % të planifikimit të kësaj takse. Gjithashtu vlen të përmendet që gjatë vitit 2018 referuar punës në terren por edhe bashkëpunimit me zyrën e urbanistikës dhe inxhinierët e rajoneve është bërë e mundur identifikimi i 7,107.1 m² sipërfaqe ndërtesë e destinuar për biznes, nga të cilat 2,885.2 m² sipërfaqe ndërtimi në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues dhe 4,221.9 m² sipërfaqe ndërtimi në të cilat ushtrohet aktivitet në fushën e tregëtimit dhe shërbimit.

Këto arsye kanë ndikuar në nivelin e realizimit të vitit 2018 në vlerën 102,952,983, lekë konkretisht nga :

- Nga 312 subjekte të biznesit të madh në vlerën 23,582,487 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 74 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2018 në vlerën 5,305,775 lekë.
- Nga 1707 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 19,544,629 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 166 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2018 në vlerën 2,106,826 lekë.
- Nga 2 organizata jo fitimprurëse në vlerën 26,966 lekë.
- Nga 273 pronarë ndërtesash të cilët ambientet e tyre ju a kanë lëshuar me qira subjekteve të biznesit të madh apo të vogël në vlerën 7,289,922 lekë si dhe nga 69 pronarë ndërtesash debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2018 në vlerën 1,234,711 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2018 në vlerën 32,067,169 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2018 në vlerën 4,214,550 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative ( Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2018 në vlerën 3,658,673 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë

me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitin 2017 por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2018 në vlerën 550,258 lekë.

- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 110,400 lekë, nga familjarë rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2018 në vlerën 168,500 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 962,915 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2018 në vlerën 2,129,202 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të taksës së ndërtesës po i ilustrojmë grafikisht:




Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi ndërtesën për intervalin kohor 2015 - 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| Taksë mbi ndërtesën | 81,586,347 | 120,053,537 | 103,192,896 | 102,952,983 |




## TAKSË MBI TRUALLIN

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 3 | Taksë mbi truallin | 7,500,000 | 9,127,377 | 122 % |

Taksa mbi truallin për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 7,500,000 lekë dhe është realizuar në masën 122 % ose në vlerë 9,127,377 lekë. Taksa mbi truallin ka filluar të aplikohet fillimisht në vitin 2016 dhe përfshin kategoritë e truallit për biznes dhe truallit për banim. Duke qënë në vitin e tretë të aplikimit të saj pavarësisht informacionit që disponojmë dhe atë të përditësuar në dy vitet e mëparëshme dhe viti 2018 vazhdoi me punën në terren në lidhje me informimin e poseiduesve të truallit për detyrimin dhe afatet e pagesës, identifikimin e sipërfaqeve truall, matjen e tyre në rastet e mungesës së dokumentacionit. Fal punës në terren por edhe bashkëpunimit me zyrën e urbanistikës, me inxhinierët e rajoneve është bërë e mundur identifikimi i 10,851m² sipërfaqe trualli në pronësi të subjekteve, pronarëve në ambientet e të

cilëve ushtrojnë aktivitet subjekte të biznesit apo familjarëve që disponojnë truall për banim. Kjo taksë është arkëtuar në këtë nivel nga:

- Nga 145 subjekte të biznesit të madh në vlerën 6,237,936 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 23 subjekte të biznesit të madh debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2018 në vlerën 667,295 lekë.
- Nga 93 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 1,271,742 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 15 subjekte të biznesit të vogël debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2018 në vlerën 112,379 lekë.
- Nga poseiduesit e truallit për banim në territorin e Bashkisë Korçë në vlerën 838,025 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të taksës mbi truallin po i ilustrojmë grafikisht :




Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi truallin për intervalin kohor 2016 - 2018:

| Vitet | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|
| **Të ardhurat për Taksën e Truallit** | **4,709,608** | **6,119,732** | **9,127,377** |




TAKSË TABELE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **4** | **Taksë tabele** | **14,173,000** | **9,551,861** | **67 %** |

Taksa e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 14,173,000 lekë dhe është realizuar në masën 67 % ose në vlerën 9,551,861 lekë. Lehtësitë fiskale që Bashkia Korçë ka ndërmarrë vitet e fundit kanë lehtësuar ndjeshëm barrën fiskale të subjekteve deri në përgjysmim të vlerës të taksës së tabelës për atë kategori subjektesh të cilat për ecurinë normale të veprimtarisë së tyre kanë zgjedhur të vendosin tabela identifikuese mbi sipërfaqën 2m², ndërsa për ato subjekte që për ecurinë normale të veprimtarisë së tyre zgjodhën të vendosin tabela identifikuese deri në 2m² Bashkia Korçë nuk aplikon asnjë taksë duke ju dhënë një mundësi të gjitha subjekteve që operojnë në territorin e Bashkisë Korçë të vendosin tabela identifikuese me zero kosto për buxhetet e tyre. Falë punës në terren, identifikimit të saktë të sipërfaqeve të tabelave identifikuese apo reklamuese, zbatimit të masave shtrënguese për debitorët e viteve të mëparëshme u arrit që brenda vitit 2018 të arkëtohej vlera prej 9,551,861 lekë.

Kjo shumë është arkëtuar nga :

- Nga 103 subjekte të cilat kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi dhe reklamimi në vlerën 8,780,273 dhe lekë.
- Nga 39 subjekte debitorë për vitet e mëparëshme që e kryen pagesën për taksën e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi gjatë vitit 2018 në vlerën 771,588 lekë.

## TAKSË E FJETJES NË HOTEL

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 5 | Taksa e fjetjes në hotel | 4,200,000 | 5,059,780 | 120 % |

Taksë fjetje në hotel për vitin 2018 është parashikuar 4,200,000 lekë dhe është realizuar në masën 120 % ose në vlerën 5,059,780 lekë. Ky realizim në këto nivele krahasuar dhe me vitet paraardhëse tregon më së miri se Bashkia Korçë falë lehtësive fiskale për të gjithë operatorët që operojnë në këtë fushë po bëhet atraksion turistik gjatë gjithë vitit. Fluksi në rritje i numrit të vizitorëve dhe turistëve ka sjellë dhe rritjen e numrit të subjekteve që japin strehim kundrejt pagesës siç janë hotelet, motelet, bujtinat dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Ky realizim në këtë vlerë apo dhe përqindje kundrejt planifikimit vjen si rezultat i punës së kryer nga ana e inspektorëve në terren, nga kontrollet e ushtruara periodikisht dhe masat e mara.

Vlera prej 5,059,780 lekë u realizua si rezultat i arkëtimit të vlerës prej 4,624,200 lekë taksë fjetje në hotel për vitin 2018 dhe arkëtimit të vlerës prej 435,580 lekë detyrime këto të viteve të mëparëshme të cilat u arkëtuan gjatë vitit 2018.

Gjithashtu ndikim kanë pasur dhe takimet periodike të zhvilluara me përfaqësues të biznesit me fokus ndërgjegjësimin e tyre në deklarimin e saktë të personave të cilëve ju ofrojnë strehim si dhe deklarimin brenda afateve të përcaktuara.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës së fjetjes në hotel për intervalin kohor 2015 - 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| Taksë fjetje në hotel | 3,327,481 | 3,191,494 | 3,931,249 | 5,059,780 |




## TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 6 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 230,000,000 | 59,464,396 | 26% |

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 230,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 26 % ose në vlerën 59,464,396 lekë.

Kjo taksë është realizuar si pasojë e dhënies së 106 lejave dhe arkëtimit të tyre konkretisht nga:

- Leje me destinacion banimi në vlerën 24,585,012 lekë, për 65 objekte
- Leje me destinacion banim + ekonomike në vlerën 26,675,523 lekë, për 11 objekte
- Leje me destinacion ekonomik në vlerën 8,203,861 lekë, për 30 objekte

## TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **7** | **Taksa e ndikimit në infrastrukurë nga legalizimet** | **37,000,000** | **26,006,146** | **70 %** |

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 37,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2018 është realizuar në masën 70 % ose në vlerën 26,006,146 lekë.

Ky realizim vjen si rezultat i legalizimit të 527 objekteve dhe kryerjes së pagesës për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndarë si më poshtë :

- Për destinacion banimi në vlerën 16,971,754 lekë, për 442 objekte
- Për destinacion banim + ekonomike në vlerën 2,873,830 lekë, për 45 objekte
- Për destinacion ekonomik në vlerën 6,160,562 lekë, për 40 objekte

## TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË (MINISTRIA E ENERGJISË)

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **8** | **Taksa e ndikimit në infrastrukurë** | **12,200,000** | **1,958,811** | **16%** |

Kjo taksë është realizuar si rezultat i pagesës nga Ministria e Energjisë të vlerës 1,958,811 lekë për taksë ndikimi në infrastrukurë të investimeve të kësaj ministrie në rrjetin energjitik.

## DIVIDENTI NGA U.K.KO

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **9** | **Dividenti nga U.K.KO** | **4,500,000** | **7,864,515** | **175%** |

Të ardhura nga Dividenti U.K.KO për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 4,500,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 7,864,515 lekë ose në masën 175 %.

## DIVIDENTI NGA TREGU I SHITJES ME SHUMICË

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 10 | Dividenti nga tregu i shitjes me shumicë | 1,200,000 | 0 | - |

Të ardhura nga dividenti i tregut të shitjes me shumicë për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 1,200,000 lekë. Për vitin 2018 nuk pati realizim të këtij zëri pasi dividenti i mbledhur i vitit 2017 kaloi për investime në Tregun me Shumicë të Fruta Perimeve, investime këto të cilat do të përmirësojnë kushtet dhe ofrimin e shërbimit si për tregëtarët e shumicës që operojnë në të ashtu edhe për subjektet të cilat kryejnë furmizimet ditore në këtë treg.

## RENTA MINERARE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 11 | Renta minerare | 100,000 | 110,375 | 110% |

Të ardhura nga renta minerare për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 100,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 110,375 lekë ose në masën 110 %. Renta minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

## TAKSË E PËRKOHSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET)

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 12 | Taksë e përkohshme për linjat | 1,800,000 | 0 | - |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **ajrore dhe nëntokësore** | | | |

Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 1,800,000 lekë dhe gjatë vitit 2018 nuk është realizuar asnjë arkëtim në lidhje më këtë taksë. Duhet të theksojmë se vazhdojnë proçedurat gjyqësore në lidhje me arkëtimin e kësaj taksë për subjektet debitore dhe se kemi mundësuar sigurimin në bankë të detyrimit për një subjekt, vlerë të cilën nuk mund të tërheqim pa mbaruar proçesi gjyqësor. Njëkohësisht po vazhdojnë proçedurat ligjore dhe për subjektet e tjera të cilat detyroheshin ta paguanin këtë taksë deri në vitin 2017, pasi edhe kjo taksë në kuadër të incentivave fiskale që ndërmori Bashkia Korçë për lehtësimin e barrës fiskale të biznesit është bërë zero për vitin 2018.

## TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **13** | **Taksë mbi tokën bujqësore** | **37,230,000** | **22,657,362** | **61 %** |

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2018 është planifikuar 37,230,000 lekë dhe është realizuar në masën 61 % ose në vlerën 22,657,218 lekë. Arkëtimi i kësaj takse nga viti në vit ka rezultuar me rritje si rezultat dhe i zbatimit të masave shtrënguese ndaj debitorëve, punës në terren në lidhje me njoftimin dhe informimin e poseiduesve të tokës bujqësore për detyrimin dhe afatet e pagesës, identifikimin e sipërfaqeve të tokës bujqësore, matjen e tyre në rastet e mungesës së dokumentacionit e.t.j. Kjo shumë është arkëtuar nga poseduesit e tokës bujqësore në Bashkinë Korçë që kryen pagesën për detyrimin e vitit 2018 në vlerën 9,200,324 lekë dhe nga debitorët e viteve paraardhëse të cilët kryen pagesën gjatë vitit 2018 në vlerën 13,457,038 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të taksës mbi tokën bujqësore për intervalin kohor 2015 - 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| **Taksë mbi tokën bujqësore** | **10,076,503** | **22,450,806** | **20,816,412** | **22,657,362** |




TAKSË E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 14 | Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor | 42,500,000 | 37,623,253 | 89 % |

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor e cila planifikohet dhe mblidhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2018 është planifikuar 42,500,000 lekë dhe realizimi i saj për vitin 2018 është në masën 89 % ose në vlerë 37,623,253 lekë. Ky realizim me rritje nga vitit në vit vjen si rezultat që përveç akt rakordimit mujor ne kemi kërkuar dhe na janë vënë në dispozicion evidenca të detajuara me numrin dhe pronësinë e mjeteve si dhe vlerën e paguar për çdo mjet, për çdo muaj, kjo me qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizimin e nivelit të bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së D.R.SH.T.RR Korçë në lidhje me këtë zë.

## TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 15 | Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme | 13,000,000 | 9,590,732 | 74 % |

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme e cila planifikohet dhe mblidhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë, për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 13,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 74 % ose e shprehur në vlerë 9,590,732 lekë. Ky realizim me rritje nga vitit në vit vjen si rezultat që përveç akt rakordimit mujor ne kemi kërkuar dhe na janë vënë në dispozicion evidenca të detajuara me numrin dhe pasuritë objekt transaksioni si dhe vlerën e paguar për çdo transaksion, për çdo muaj, kjo me qëllim rritjen e transparencës midis dy institucioneve, fuqizimin e nivelit të bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës së Z.V.R.P.P Korçë në lidhje me këtë zë.

## TË ARDHURA NGA TARIFAT

### TARIFË E PASTRIMIT

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 16 | Tarifë e Pastrimit | 165,261,000 | 155,983,218 | 94 % |

Tarifa e pastrimit për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 165,261,000 lekë dhe është realizuar në masën 94% ose në vlerë 155,983,218 lekë. Kjo shumë është arkëtuar :

- Nga 652 subjekte të biznesit të madh në vlerën 46,336,060 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 96 subjekte të Biznesit të Madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2018 në vlerën 3,395,851 lekë.
- Nga 2710 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 24,642,278 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 209 subjekte të Biznesit të Vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2018 në vlerën 1,286,046 lekë.

- Nga 98 subjekte ndërtuese që kanë paguar tarifën e pastrimit për çdo kantier ndërtimi pasi kanë tërhequr lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Korçë, në vlerë 3,730,000 lekë detyrime këto të vitit 2018.
- Nga 74 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 2,217,500 lekë detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 9 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2018 në vlerën 208,334 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2018 në vlerën 56,263,195 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2018 në vlerën 7,104,612 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2018 në vlerën 5,282,401 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitin 2017 por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2018 në vlerën 830,102 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 254,600 lekë, nga abonentët familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2018 në vlerën 1,254,232 lekë
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 1,076,120 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2018 në vlerën 2,101,887 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së pastrimit po i ilustrojmë grafikisht :




Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së pastrimit për intervalin kohor 2015 - 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| **Tarifë Pastrimi** | **73,698,794** | **109,957,985** | **112,670,439** | **155,983,218** |




## TARIFË NDRIÇIMI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **17** | **Tarifë Ndriçimi** | **41,101,667** | **37,942,813** | **92%** |

Tarifa e ndriçimit për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 41,101,667 lekë dhe është realizuar në masën 92% ose në vlerë 37,942,813 lekë. Kjo shumë është arkëtuar :

- Nga 632 subjekte të biznesit të madh në vlerën 7,160,933 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 96 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2018 në vlerën 586,347 lekë.
- Nga 2508 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 10,706,590 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 207 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2018 në vlerën 561,704 lekë.
- Nga 98 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 285,000 lekë detyrime këto të vitit 2018.
- Nga 74 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 366,250 lekë detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 9 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2018 në vlerën 55,834 lekë.
- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2018 në vlerën 11,516,070 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2018 në vlerën 2,397,260 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2018 në vlerën 1,980,673 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitin 2017 por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2018 në vlerën 410,490 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 48,300 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2018 në vlerën 405,634 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 350,858 lekë si dhe nga familjarët rezidentë

efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2018 në vlerën 1,110,871 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së ndriçimit po i ilustrojmë grafikisht :




Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së ndriçimit për intervalin kohor 2015 - 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| **Tarifë ndriçimi** | **27,549,002** | **36,317,435** | **36,266,541** | **37,942,813** |




## TARIFË GJELBËRIMI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **18** | **Tarifë Gjelbërimi** | **28,383,500** | **24,707,001** | **87 %** |

Tarifa e gjelbërimit për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 28,383,500 lekë dhe është realizuar në masën 87 % ose në vlerë 24,707,001lekë. Kjo shumë është arkëtuar:

- Nga 593 subjekte të biznesit të madh në vlerën 4,418,811 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 84 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2018 në vlerën 529,179 lekë.
- Nga 2294 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 8,469,520 lekë, detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 171 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2018 në vlerën 478,217 lekë.
- Nga 98 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 373,000 lekë detyrime këto të vitit 2018.
- Nga 74 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 381,250 lekë detyrime këto të vitit 2018 si dhe nga 8 institucione shtetërore dhe organizata jo

fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2018 në vlerën 50,834 lekë.

- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2018 në vlerën 7,969,787 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitore për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2018 në vlerën 1,731,500 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 34,000 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitore për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2018 në vlerën 270,903 lekë.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizmin total të tarifës së gjelbërimit po i ilustrojmë grafikisht :




Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës së gjelbërimit për intervalin kohor 2015 - 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| **Tarifë gjelbërimi** | **17,224,889** | **22,321,664** | **23,683,772** | **24,707,001** |




## TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 19 | Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike | 2,000,000 | 483,544 | 24 % |

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike për vitin 2018 është planifikuar 2,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 24 % ose në vlerën 483,544 lekë. Edhe kjo është një tarifë e cila në vitin 2018 u përgjysmua  në kuadër të incentivave fiskale që ndërmori Bashkia  Korçë për lehtësimin e barrës fiskale të bizneseve. Gjithashtu vazhdojnë proçedurat e zbatimit të masave shtrënguese për subjektet të cilat nuk e paguan këtë tarifë gjatë vitit 2018 apo dhe për ato subjekte apo pronarë ndërtesash të cilat nuk e kanë paguar në vitet e mëparëshme.

## TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 20 | Tarifë regjistrimi për lejë transporti | 3,700,000 | 1,065,480 | 29% |

Tarifë regjistrimi leje transporti për vitin 2018 është planifikuar 3,700,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 29 % ose në vlerë 1,065,480 lekë. Realizimi i kësaj tarifë vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

- Transport malli 87,630 lekë.
- Transport udhëtarësh me taksi 325,600 lekë.
- Transport udhëtarësh me linjë qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse 511,250 lekë.
- Autorizime kamioni të tonazhit të rëndë 141,000 lekë.

## TARIFË PARKIMI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 21 | Tarifë Parkimi | 24,000,000 | 20,666,333 | 86% |

Tarifë parkimi për vitin 2018 është planifikuar 24,000,000 lekë dhe deri në fund të vitit 2018 është realizuar në masën 86 % ose në vlerë 20,666,333 lekë. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

- Tarifa e parkimit të rezervuar për institucionet shtetërore apo subjektet private, tarifa e parkimit në shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksi, tarifa e parkimit të subjekteve transportit të udhëtarëve që operojnë me linja ndërqytetëse për vitin 2018 duke përfshirë këtu dhe detyrimet debitore për vitet paraardhëse në vlerën 5,491,333 lekë
- Tarifë parkimi e arkëtuar nga subjekti i kontraktuar për vjeljen e tarifës së parkimit në qytet në vendparkimet e miratuara me pagesë në vlerën 15,175,000 lekë.

## TARIFË MUR PERIMETRAL

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 22 | Tarifë mur perimetral | 1,450,000 | 628,832 | 43% |

Tarifë mur perimetral për vitin 2018 është planifikuar 1,450,000 lekë dhe është realizuar në masën 43 % ose në vlerë 628,832 lekë. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies së 69 lejave dhe arkëtimit të tyre konkretisht nga:

- Leje për destinacion banimi në vlerën 30,632 lekë, për 43 objekte
- Leje për destinacion banim+ekonomike në vlerën 202,460 lekë, për 10 objekte
- Leje për destinacion ekonomik në vlerën 395,740 lekë, për 16 objekte

## TARIFË PËR LEJET E ZHVILLIMIT ( TREGUESIT E NDËRTIMIT )

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 23 | Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit) | 1,200,000 | 440,000 | 37 % |

Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit) për vitin 2018 është planifikuar 1,200,000 lekë, dhe është realizuar në masën 37 % ose në vlerën 440,000 lekë. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies për 88 leje zhvillimi.

## TARIFË PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË TUBACIONEVE NËNTOKËSORE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 24 | Tarifë për dhënien në përdorim të tubacioneve nëntokësore | 1,500,000 | 5,040 | - |

Tarifë për dhënien në përdorim të tubacioneve nëntokësore për vitin 2018 është planifikuar 1,500,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 5,040 lekë.

## TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 25 | Tarifë për zënien e hapësirave publike | 17,800,000 | 15,048,221 | 85 % |

Tarifë për zënie hapësire publike për vitin 2018 është planifikuar 17,800,000 lekë dhe është realizuar në masën 85 % ose në vlerën 15,048,221 lekë. Më të detajuar po e paraqesim :

- Tek inkubatori i biznesit (ish U.M.B) dhe tregje të miratuara nga Bashkia ne vlerën 3,355,200 lekë
- Hapësire publike 10,610,321 lekë
- Ekspozim malli në vlerën 852,000 lekë
- Promocione dhe panaire në vlerën 230,700 lekë

Ky realizim në këtë nivel vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese të ndërmara nga ana e Bashkisë Korçë, si rezultat i punës së kryer nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet për zënien e hapësirave publike si dhe në ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife brenda afateve të përcaktuara.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për zënien e hapësirave publike për intervalin kohor 2015 - 2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| **Tarifë për zënien e hapësirave publike** | **637,434** | **7,491,437** | **9,184,159** | **15,048,221** |



## TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 26 | Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit | 1,900,000 | 782,100 | 41 % |

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2018 është parashikuar në vlerën 1,900,000 lekë dhe është realizuar në masën 41 % ose në vlerën 782,100 lekë. Arkëtimi i kësaj tarife gjatë vitit 2018 vjen si rezultat i masave shtrënguese që janë marrë ndaj subjekteve debitore të vitit 2017, pasi prej vitit 2018 subjektet të cilat operonin dhe shërbenin me tavolina në hapësira publike nuk e paguajnë më këtë tarifë, një tjetër lehtësi fiskale kjo e ndërmarë nga Bashkia Korçë në kuadër të uljes së barrës fiskale ndaj biznesit.

## TARIFË UJI I PIJSHËM

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 27 | Tarifë uji | 450,000 | 129,372 | 29 % |

Tarifa e ujit për vitin 2018 është planifikuar 450,000 lekë dhe është realizuar në masën 29 % ose në vlerën 129,372 lekë. Zbatimi i VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 në përputhje me ndarjen e re administrative territoriale sipas parimit një bashki një shoqëri UK ka patur parasysh përfshirjen e ujësjellësave të fshatrave në zonën e shërbimit të UKKO. Kjo ishte një risi mjaft të madhe për U.K.KO dhe Bashkinë Korçë që të ruanin apo siguronin qëndrueshmërinë financiare duke ofruar shërbime me cilësi për të gjithë konsumatorët.Ky realizim në këtë masë vjen si rezultat se prej muajit qershor 2016 e në vazhdim të gjitha ujësjellësat e njësive administrative të bashkisë Korçë i kaluan për menaxhim Ndërmarjes U.K.KO apo pleqësive të fshatrave. Nga kjo periudhë vazhdojnë të arkëtohen të gjitha debitë për tarifën e ujit të akumuluara në vite në çdo njësi administrative të Bashkisë Korçë me përjashtim të Njësisë Administrative Korçë .

## TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **28** | **Tarifë mirëmbajtje varreza publike** | **16,150,000** | **14,273,419** | **88 %** |

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike për vitin 2018 është planifikuar 16,150,000 lekë dhe është realizuar në masën 88 % ose në vlerën 14,273,419 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga:

- Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2018 në vlerën 8,781,412 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2018 në vlerën 1,443,826 lekë.
- Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2018 në vlerën 2,075,071 lekë si dhe nga abonentët familjarë të Njësive Administrative të cilët ishin debitorë për vitin 2017 por që kryen pagesën në vitin 2018 në vlerën 410,490 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2018 në vlerën 34,500 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2018 në vlerën 59,538 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 345,858 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë të cilët ishin debitorë për vitet paraardhëse dhe kanë kryer pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2018 në vlerën 1,122,724 lekë.

Më poshtë nëpërmjet tabelës dhe grafikut po japim trendin e realizimit të tarifës për mirëmbajtje varreza publike për periudhën 2015 –2018:

| Vitet | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|---|---|---|---|
| **Tarifë mirëmbajtje varreza publike** | **1,059,477** | **10,597,898** | **12,908,387** | **14,273,419** |




## TARIFË THERJE BAGËTIE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 29 | Tarifë therje bagëtie | 1,000,000 | 2,397,550 | 240% |

Tarifë therrje bagëtie për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2018 është në masën 240 % ose në vlerën 2,397,550 lekë. Ky realizim ka ardhur si rezultat i therrjes së 30,578 krerëve gjatë vitit 2018 nga të cilat konkretisht:

- 18,718 bagëti të imta në vlerën 935,900 lekë
- 5,791 gjedhë në vlerën 1,158,200 lekë
- 6,069 derra në vlerën 303,450 lekë

## TARIFË PËR LEJË NDËRTIMI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 30 | Tarifë për leje ndërtimi | 450,000 | 123,000 | 27% |

Tarifë për leje ndërtimi për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 450,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2018 është në masën 27 % ose në vlerën 123,000 lekë. Kjo tarifë është realizuar si pasojë e dhënies për 96 leje ndërtimi.

## QIRA OBJEKTI,QIRA TRUALLI DHE QIRA TOKË BUJQËSORE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 31 | Qira objekti, Qira trualli, Qira T.bujqësore e.t.j | 19,920,000 | 1,908,587 | 10 % |

Qira objekti, qira trualli, qira tokë bujqësore e.t.j për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 19,920,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2018 është në masën 10 % ose në vlerën 1,908,587 lekë.

Konkretisht realizimi i këtij zëri në këtë nivel vjen si rezultat i :

- Arkëtimit të 253,786 lekë nga zëri qira trualli.
- Arkëtimit të 1,411,510 lekë nga zëri qira objekti.
- Arkëtimit të 243,291 lekë nga zëri qira tokë bujqësore.

## TARIFË SHËRBIMI , VËRTETIME , ÇERTIFIKATA

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 32 | Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata etj. | 12,327,000 | 4,720,333 | 38 % |

Të ardhura të tjera ku përfshihen (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, lejë ushtrimi aktiviteti, tarifë regjistrim biznesi, etj), për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 12,327,000 lekë dhe është realizuar në masën 38 % ose në vlerën 4,720,333 lekë.

Këtë realizim po e detajojmë sipas zërave përbërës:

- Tarifë regjistrim biznesi në vlerën 95,000 lekë ( arkëtuar nga 1 subjekt i biznesit të madh është arkëtuar në vlerën 20,000 lekë dhe nga 8 subjekte të biznesit të vogël është arkëtuar në vlerën 75,000 lekë)

- Kamatë vonesa në vlerën 276,798 lekë
- Tarifë administrative dhe rregullatore e njësive vendore në vlerën 72,600 lekë
- Licenca apo leje për ushtrim aktiviteti në vlerën 2,877,500 lekë
- Të ardhura sekondare dhe të ardhura nga debitorë në vlerën 190,682 lekë
- Tarifë vendore për lëshime vërtetimi në vlerën 478,000 lekë
- Tarifë vendore për konfirmime hartash në vlerën 51,300 lekë,
- Tarifë vendore për çertifikata përdorimi në vlerën 642,953 lekë
- Tarifë vendore e sistemimeve të jashtme për leje ndërtimi në vlerën 35,500 lekë,

## ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **33** | **Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri** | **500,000** | **498,400** | **100 %** |

Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 500,000 lekë dhe është realizuar në masën 100 % ose në vlerën 498,400 lekë.

Konkretisht janë lëshuar 93 çertifikata për mbrojtjen nga zjarri prej të cilave 57 kanë qenë rinovim çertifikate dhe 36 çertifikata kanë qenë për herë të parë. Më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

- 43 çertifikata të tregut të karburanteve, pikave të GLN, autoboteve të karburantit dhe GLN.
- 16 çertifikata të bankave të nivelit të dytë.
- 23 çertifikata të subjekteve tregëtare, shërbimi dhe prodhimi
- 11 çertifikata për objekte biznesi dhe banimi

## MIRATIM PROJEKTI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **34** | **Miratim projekti** | **300,000** | **119,000** | **40 %** |

Miratim projekti për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 300,000 lekë dhe është realizuar në masën 40 % ose në vlerën 119,000 lekë. Kjo tarifë arkëtohet konkretisht nga miratimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri për çdo lejë ndërtimi. Konkretisht janë miratuar 17 projekte të cilat më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

- 14 projekte për banesa.
- 1 projekt për shtesë hoteli
- 1 projekt për Hidrocentral në Vithkuq
- 1 projekt për objekt social kulturor, Universiteti "F.S Noli"

## SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 35 | Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara | 250,000 | 0 | - |

Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 250,000 lekë. Gjatë vitit 2018 nuk pati asnjë rast për të ndërhyrë në objekte të siguruara si dhe nuk u arkëtuan detyrimet për ndërhyrjet e kryera në vitet e mëparëshme.

## SHËRBIME ZJARRFIKSE NË BASHKI FQINJE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 36 | Shërbime zjarrfikse në bashki fqinje | 300,000 | 0 | - |

Shërbime zjarrfikse në bashki fqinje për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 300,000 lekë.Gjatë vitit 2018 u kryen gjithsej 5 ndërhyrje me shërbimin zjarrfikëse në bashki fqinje me vlerë 151,250 lekë, shumë e cila nuk mundi të transferohej nga Ministria e Brendshme brenda vitit 2018, gjithashtu po gjatë vitit 2018 nuk u transferua dhe vlera e ndërhyrjeve të kryera gjatë vitit 2017.

## MARRJE ME QIRA PYJE/KULLOTA

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 37 | Marrje me qira pyje/kullota | 10,900,000 | 13,872,624 | 127 % |

Marrje me qira pylli për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 10,900,000 lekë dhe është realizuar në masën 127 % ose në vlerën 13,872,624 lekë. Kjo vlerë është arkëtuar nga: 2 kontrata qiraje të lidhura me qëllim pushim, argëtim në vlerën 90,000 lekë, 2 kontrata qiraje të lidhura për akuakulturë në vlerën 38,200 lekë, 6 kontrata qiraje të lidhura me kompanitë celulare në vlerën 1,326,750 lekë, 1 kontratë qiraje e lidhur për gurore ne vlerën 72,512 lekë, 4 kontrata qiraje të lidhura për ndërtim HEC-i në vlerën 1,774,505 lekë, 2 kontrata qiraje të lidhura për mbjellje arrorësh në vlerën 633,000 lekë, 14 kontrata qiraje të lidhura me TAP për shtrimin e tubacionit në vlerën 8,703,457 lekë dhe 32 kontrata për kullotje në vlerën 1,234,200 lekë.

## TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 38 | Të ardhura nga shitja e druve | 5,000,000 | 3,755,676 | 75 % |

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 5,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 75 % ose në vlerën 3,755,676 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga pagesa e 1 kontrate shfrytëzimi të lidhur në vitin 2017 në vlerën 1,540,686 lekë, 1 kontratë për ndërtim HEC i cili ka paguar materialin drusor në vlerën 68,000 lekë dhe 3 kontrata të lidhura me TAP për shtrimin e tubacionit i cili ka paguar materialin drusor në vlerën 2,146,990 lekë.

## VËRTETIME TRANSPORTI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 39 | Vërtetime transporti | 100,000 | 108,000 | 108 % |

Të ardhura nga vërtetime transporti për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 100,000 lekë dhe është realizuar në masën 108 % ose në vlerën 108,000 lekë. Vlerë kjo e arkëtuar nga shitja e 30

blloqe vërtetime transporti për pyll Bashkiak në vlerën 90,000 lekë dhe 3 blloqe vërtetime transporti për pyll privat në vlerën 18,000 lekë.

## PRODHIME TË DYTA MEDICINALE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 40 | Prodhime të dyta medicinale | 300,000 | 289,250 | 96 % |

Të ardhura nga prodhime të dyta medicinale për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 300,000 lekë dhe është realizuar në masën 96 % ose në vlerën 289,250 lekë. Vlerë kjo e arkëtuar nga fituesi i ankandit me objekt mbledhjen, grumbullimin dhe shitjen e bimëve medicinale.

## SHITJE DOKUMENTA ANKANDI

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 41 | Shitje dokumenta ankandi | 1,000 | 1,000 | 100 % |

Të ardhura nga shitje dokumenta ankandi për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 1,000 lekë është realizuar në masën 100 % ose në vlerën 1,000 lekë . Vlerë kjo e arkëtuar nga subjekti fitues i ankandit për mbledhjen, grumbullimin dhe shitjen e bimëve medicinale.

## GJOBË POLICIA BASHKIAKE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 42 | Gjobë Policia Bashkiake | 2,000,000 | 2,557,000 | 128 % |

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2018 është planifikuar 2,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2018 është në masën 128% ose në vlerën 2,557,000 lekë.

Gjatë vitit 2018 në total janë vendosur 2465 gjoba ( 2322 gjoba për parkim të gabuar dhe 143 gjoba për shkelje të hapësirave publike nga subjekte tregtare) në vlerën 2,785,000 lekë nga të cilat 2372 janë arkëtuar brenda vitit 2018 në vlerën 2,542,000 lekë dhe 43 gjoba për vlerën 243,000 lekë nuk mundën të arkëtohen brenda vitit 2018. Gjithashtu po brenda vitit 2018 u

arkëtuan 5 gjoba në vlerën 15,000 lekë të pa arkëtuara këto nga vitet e mëparëshme dhe mbeten për tu arkëtuar dhe 19 gjoba në vlerë 66,000 lekë nga vitet e mëparëshme për të cilat po ndiqen të gjitha proçedurat ligjore për arkëtimin e tyre. Gjithashtu janë parashkruar 12 gjoba me vlerë 36,000 lekë të vendosura gjatë vitit 2016**.**

## GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **43** | **Gjobë për vonesë në pagesë** | **7,500,917** | **7,466,884** | **100 %** |

Gjoba për vonesë në pagesë për vitin 2018 është planifikuar 7,500,917 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2018 është në masën 100 % ose në vlerën 7,466,884 lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 7,466,884 lekë, konkretisht :

- Nga subjektet e biznesit të madh të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2018 në vlerën 1,574,609 lekë.
- Nga subjektet e biznesit të vogël të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2018 në vlerën 1,635,747 lekë.
- Nga institucionet dhe ojf - të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2018 në vlerën 3,458 lekë.
- Nga pronarët e ndërtesave të cilët nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2018 në vlerën 286,422 lekë.
- Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të cilët nuk i paguan detyrimet e viteve të mëparëshme brenda afateve të përcaktuar në vlerën 1,110,370 lekë.
- Nga debitorët për vitet e mëparëshme nga subjektet e biznesit të vogël, të madh, pronarët e ndërtesave në vlerën 2,856,278 lekë.

## GJOBË KOLAUDIMI MATERIALE DRUSORE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **44** | **Gjobë kolaudimi materiale drusore** | **0** | **36,200** | **-** |

Gjoba kolaudimi materiale drusore për vitin 2018 është realizuar në vlerën 36,200 lekë. Vlerë kjo e arkëtuar nga kolaudimi i ngastrave 1a, 1b të ekonomisë pyjore Bofje – Dushar 1, sipas kontratës të lidhur me subjektin Ardit Sh.p.k  për shfrytëzimin e materialit drrusor.

## GJOBË TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 45 | Gjobë të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit | 1,500,000 | 341,500 | 23% |

Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 1,500,000 lekë, dhe është realizuar në masën 23 % ose në vlerën 341,500 lekë. Gjatë vitit 2018 në total janë vendosur 31 gjoba në vlerën 520,000 lekë  nga të cilat :

- 15 gjoba janë arkëtuar brenda vitit 2018 në vlerën 240,000 lekë
- nga arkëtimi i 2 gjobave të sektorit të kontrollit veterinar  në vlerë 10,000 lekë,
- nga arkëtimi i 5 gjobave të specialistit të transportit në lidhje me prerjen e biletës së parkimit me pagesë në vlerë 1,500 lekë
- Nga 10 gjoba të pambledhura për vitet 2016-2017 të cilat u arkëtuan  gjatë vitit 2018 konkretisht në vlerën 90,000 lekë.
- Mbeten të pa arkëkuara 16 gjoba në vlerën 220,000 lekë për të cilat po ndiqen të gjitha proçedurat ligjore për arkëtimin e tyre gjatë këtij viti.

## GJOBË TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| 46 | Gjobë të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor | 3,600,000 | 2,160,000 | 60% |

Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2018  është planifikuar në vlerën 3,600,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2018 është në masën 60 % ose në vlerën 2,160,000 lekë. Gjatë vitit 2018 nga ky inspektoriat u vendosën gjithsej 9 gjoba me vlerë totale 1,160,000

lekë, prej të cilave janë likujduar 8 gjoba në vlerë 1,060,000 lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2018 janë arkëtuar 5 gjoba të cilat ishin për tu ekzekutuar nga përmbarimi në vlerë 1,100,000 lekë konkretisht: 1 gjobë e vitit 2013 në vlerën 400,000 lekë, 2 gjoba të vitit 2014 me vlerë 150,000 lekë dhe 2 gjoba të vitit 2017 me vlerë 550,000 lekë.

## GJOBË TË DREJTORISË TË TË ARDHURAVE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **47** | **Gjoba të Drejtorisë të të ardhurave** | **300,000** | **60,000** | **20 %** |

Gjoba të Drejtorisë të të Ardhurave për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 300,000 dhe është realizuar në vlerën 60,000 lekë. Konkretisht gjatë vitit 2018 janë ushtruar 594 kontrolle nga specialistët e kontrollit dhe vjeljes së të ardhurave në subjektet akomoduese nga të cilat kanë rezultuar në shkelje për mos deklarim dhe është vendosur masa e gjobës për 6 subjekte në vlerë 120,000 lekë, 3 prej të cilave janë likujduar brenda vitit 2018 në vlerë 60,000 lekë dhe mbeten për tu vjelë gjatë vitit 2019 edhe 3 gjoba me vlerë 60,000 lekë.

## TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **48** | **Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)** | **6,962,400** | **6,929,215** | **100 %** |

Të ardhurat nga qeratë, (banesa sociale) për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 6, 962,400 lekë dhe është realizuar në masën 100 % ose në vlerën 6,929,215 lekë.

## QIRA NGA BANESAT QË KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **49** | **Qira nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave** | **5,377,573** | **3,243,939** | **60 %** |

Të ardhurat nga qiratë, (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave) për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 5,377,573 lekë dhe është realizuar në masën 60 % ose në vlerën 3,243,939 lekë.

KAMATË VONESA

| Nr | Lloji i taksës ose tarifës | Planifikimi 2018 | Realizimi 2018 | Përqindja |
|---|---|---|---|---|
| **50** | **Kamatë vonesa** | **500,000** | **417,314** | **83 %** |

Kamatë vonesë për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 500,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 417,314 lekë ose në masën 83 % si rezultat i zbatimit të kushteve të kontratës së qiradhënies (1% për çdo ditë vonesë nga afati i përcaktuar në kontratë).

## Fondet buxhetore 2018

Përdorimi i transfertës së kushtëzuar të vitit 2018 për Bashkinë Korçë jepet e detajuar në tabelën e mëposhtme:

**Tabela: Transferta e kushtëzuar**

000/lekë

| Emërtimi | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shp.page 600 | | Shp,sig.shoq.shendet 601 | | Shp.operative 602 | | Subvencione 603 | | Tr. Tek individet 606 | | Shp. Investime 231 | | Total | |
| Gjendja civile | 7,525 | 7,169 | 1,273 | 1,197 | | | | | | | | | 8,798 | 8,366 |
| Shpërblim për regjistrim lindje | | | | | | | | | 1,290 | 1,290 | | | 1,290 | 1,290 |
| Transferta tek individet | | | | | | | | | 53 | 53 | | | 53 | 53 |
| QKB | 1,204 | 866 | 201 | 145 | 70 | 60 | | | | | | | 1,475 | 1,071 |
| Subvencion per matesat e ujit | | | | | | | 106 | 53 | | | | | 106 | 53 |
| Ndihma ekonomike | | | | | | | | | 29,743 | 29,627 | | | 29,743 | 29,627 |
| Paaftesia | | | | | | | | | 517,262 | 517,262 | | | 517,262 | 517,262 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Sherbime te tjera (Bursa arsimi parauniversitar)** | | | | | 5,483 | 2,629 | | | | | | | 5,483 | 2,629 |
| **Bursa dhe gjysme bursa arsimi parauniversitar shk.profesionale** | | | | | | | | | 20,959 | 13,779 | | | 20,959 | 13,779 |
| **Uniforma dhe veshje te tjera speciale** | | | | | 1,112 | 1,012 | | | | | | | 1,112 | 1,012 |
| **Investime ne arsimin parauniversitar** | | | | | | | | | | | 25,370 | 19,899 | 25,370 | 19,899 |
| **Total** | **8,729** | **8,035** | **1,474** | **1,342** | **6,665** | **3,701** | **106** | **53** | **569,307** | **562,011** | **25,370** | **19,899** | **611,651** | **595,041** |

-Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore për gjendjen civile për vitin 2018, ka qenë në vlerën 8,798 mijë lekë dhe realizimi 8,366 mijë lekë ose 95%.

-Fondi për shpërblim regjistrim lindjeje në vlerën 1,290 mijë lekë. Ky fond u realizua në vlerën 1,290 ose në masën 100% . Nga ky fond përfituan 258 fëmijë.

-Fondi për transferta tek individët për vitin 2018 ka qenë në vlerën 53 mijë lekë dhe realizimi ka qenë 53 mijë lekë ose 100% dhe është përdorur për shpërblim dalje në pension.

Buxheti i Q.K.B. është përdorur për:

-Fondi për paga ka qenë 1,204 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 866 mijë lekë ose 72%.

-Fondi për sigurime shoqërore ka qenë në vlerën 201 mijë lekë dhe realizimi 145 mijë lekë ose 72%.

-Fondi për shpenzime operative ka qenë në vlerën 70 mijë lekë dhe realizimi 60 mijë lekë ose 86%.

-Fondi për subvencion për matësat e ujit ka qenë në vlerën 106 mijë lëkë dhe realizimi 53 mijë lekë ose 50%.

-Fondi për ndihmën ekonomike për vitin 2018 ka qenë në vlerën 29,743 mijë lëkë dhe realizimi 29,627 mijë lekë ose 99%.

-Fondi për pagesën e paaftësisë për vitin 2018 ka qenë në vlerën 517,262 mijë lëkë dhe realizimi 517,262 mijë lekë ose 100%.

-Fondi për shërbime të tjera (bursat e arsimit parauniversitar) për vitin 2018 ka qenë në vlerën 5,483 mijë lëkë dhe realizimi 2,629 mijë lekë ose 48%.

-Fondi për bursat dhe gjysmë bursat e arsimit parauniversitar për shkollat profesionale për vitin 2018 ka qenë në vlerën 20,959 mijë lëkë dhe realizimi 13,779 mijë lekë ose 66%. Fondi për uniforma dhe veshje speciale për shkollat profesionale, për vitin 2018 ka qenë 1,112 mijë lekë dhe realizimi 1,012 mijë lekë ose 91%.

- ✓ **Investime në arsim**

Investimet në arsim, të miratuara me VKM, paraqiten të detajuara si më poshtë:

-Për objektin **"Rikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare Abdulla Asabella, Vinçan"** vlera e kontratës është 20,340,115 lekë dhe është financuar për 2 vite buxhetore. Vlera prej 15,092,698 lekë u realizua gjatë vitit 2017. Vlera prej 5,247,417 lekë u financua gjatë vitit 2018 dhe u realizua 5,213,711 lekë.

-Për objektin **"Rikonstruksioni + shtesë shkolla 9 vjeçare Lumalas" v**lera e kontratës është 11,909,962 lekë dhe është financuar për 2 vite buxhetore. Vlera prej 8,350,000 lekë u financua gjatë vitit 2017. Vlera prej 5,941,954 lekë u financua gjatë vitit 2018 dhe u realizua 3,555,224 lekë.

-Për objektin **"Rikonstruksioni + shtesë për palestër shkolla 9 vjeçare Naim Frashëri" v**lera e kontratës është 26,233,536 lekë dhe është financuar për 2 vite buxhetore, 2018 dhe 2019. Burimi i financimit të investimit është nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga Buxheti i Shtetit. Vlera prej 11,130,000 lekë u financua gjatë vitit 2018 dhe u realizua 11,130,000 lekë. Vlera prej 15,103,536 lekë do të financohet gjatë vitit 2019 nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga Buxheti i Shtetit.

-Për objektin **"Ndërtim shkolla 9 vjeçare Voskopojë" v**lera e kontratës është 32,250,952 lekë dhe është financuar për 2 vite buxhetore, 2018 dhe 2019. Burimi i financimit të investimit është nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga Buxheti i Shtetit. Vlera prej 3,051,100 lekë u financua gjatë vitit 2018. Vlera e mbetur 29,199,852 lekë do të financohet gjatë vitit 2019 nga të ardhurat e Bashkisë dhe nga Buxheti i Shtetit.

## Realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 sipas funksioneve dhe institucioneve

**Tabela: Shpenzimet e realizuara për vitin 2018, sipas funksioneve në 000/lekë**

| Nr. | Shpenzimet | Plan | Fakt | % për çdo zë ndaj totalit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shpenzime personeli (paga+sigurime shoqërore) | 654,314 | 577,167 | 88% |
| 2 | Shpenzimet operative dhe shërbime publike | 576,807 | 447,009 | 77% |
| 3 | Shpenzime (principali & interesi) | 57,100 | 55,261 | 97% |
| 4 | Subvencione | 10,000 | 8,499 | 85% |
| 5 | Transferta tek organizata të ndryshme | 136,074 | 57,382 | 42% |
| 6 | Transferta tek individët | 7,414 | 4,173 | 56% |
| 7 | Hartim projektesh dhe oponenca teknike | 421 | 421 | 100% |
| 8 | Fondi rezerve dhe fondi i kontigjences | 2,000 | | |
| 9 | Shpenzime kapitale | 457,988 | 198,374 | 46% |
| 10 | Shpenzime kapitale VKM | 178,073 | 81,278 | 46% |
| 11 | Shpenzime kapitale FZHR | 486,170 | 433,004 | 89% |
| | **Total** | **2,566,361** | **1,862,569** | **73%** |

**Tabela: Shpenzimet e realizuara për vitin 2018, sipas institucioneve duke përfshirë dhe funksionet e reja nga transferta specifike në 000/lekë**

**000/lekë**

| Nr. | Institucioni | Shp. Personeli | Shp. Operative +shërbime publike | Subvencion | Transferta tek organizata | Transferta tek individët | Shpenzime kapitale (plus hartim i oponencave teknike) | Shpenzime (principali & interesi) | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkia | 152,671 | 184,302 | 8,499 | 57,382 | 1,058 | 669,638 | 55,261 | **1,128,811** |
| 2 | Ndërmarja e Shërbimeve Publike | 149,619 | 114,029 | | | 344 | 36,221 | - | **300,213** |
| 3 | Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes | 231,448 | 79,626 | | | 2,623 | 5,762 | - | **319,459** |
| 4 | Qendra e Artit dhe Kulturës | 26,967 | 42,799 | | | 85 | 984 | - | **70,835** |
| 5 | Klubi Shumësportësh | 8,728 | 20,573 | | | 63 | 119 | - | **29,483** |
| 6 | Klubi i Futbollit | 4,341 | 3,935 | | | | - | - | **8,276** |
| 7 | Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social | 1,647 | 507 | | | | 354 | - | **2,508** |
| 8 | Shtëpia e Foshnjës | 1,746 | 158 | | | | - | - | **1,904** |
| 9 | Qendra Ditore e Zhvillimit | - | 487 | | | | - | - | **487** |
| 10 | Qendra Rezidenciale e Zhvillimit | - | 593 | | | | - | - | **593** |
| | **Total** | **577,167** | **447,009** | **8,499** | **57,382** | **4,173** | **713,078** | **55,261** | **1,862,569** |

**Transfertat specifike**

Pjesë përbërëse e buxhetit të Bashkisë për vitin 2018 kanë qenë dhe funksionet e reja të financuara nga transferta specifike si:

-Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

-Administrimi i pyjeve

-Ujitja dhe kullimi

-Rrugët rurale

-Arsimi parashkollor

-Arsimi parauniversitar

-Konviktet e arsimit parauniversitar

- **Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi**

Fondi i planifikuar nga transferta specifike për këtë shërbim ka qenë në vlerën 31,042 mijë lekë, e detajuar si më poshtë:

-Fondi i planifikuar për paga ka qenë në vlerën 23,348 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 21,228 mijë lekë ose në masën 91%.

-Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore ka qenë në vlerën 3,907 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 3,539 mijë lekë ose në masën 91%.

-Fondi i planifikuar për shpenzime operative ka qenë në vlerën 3,725 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 2,270 mijë lekë ose në masën 61%.

| | Përshkrimi i investimit | Pl 2018 | Fakt 12m | Det 17 | F +Det | % e realizimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kancelari e letër | 25 | 17 | | 17 | 68% |
| | Materiale elektrike | 35 | 35 | | 35 | 100% |
| | Dru zjarri | 300 | 180 | | 180 | 60% |
| | Blloqe administrative letra me vlerë | 30 | 28 | | 28 | 93% |
| | Energji elektrike | 500 | 340 | | 340 | 68% |
| | Shpenzime uji | 250 | 128 | | 128 | 51% |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Karburant | 900 | 680 | | 680 | 76% |
| | Riparim paisje makinash | 210 | 202 | | 202 | 96% |
| | Siguracion mjetesh transporti | 290 | 108 | | 108 | 37% |
| | Interneti | 39 | 24 | | 24 | 62% |
| | TVMP dhe SGS | 316 | 79 | | 79 | 25% |
| | Dieta | 25 | | | 0 | 0% |
| | Vaj filtra | 30 | | | 0 | 0% |
| | Materiale pastrimi | 40 | 16 | | 16 | 40% |
| | Bojë printeri e fotokopjuesi | 50 | | | 0 | 0% |
| | Telefon | 30 | | | 0 | 0% |
| | Vendime gjyqësore | 100 | | | 0 | 0% |
| | Uniforma pune për efektivin zjarrfikës | 465 | | 343 | 343 | 74% |
| | Karburant (detyrim 2017) | 85 | | 85 | 85 | 100% |
| | Internet (detyrim 2017) | 5 | | 5 | 5 | 100% |
| | **TOTAL** | **3,725** | **1,837** | **433** | **2,270** | **61%** |

-Fondi i planifikuar për transferta tek individët ka qenë në vlerën 62 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 62 mijë lekë ose në masën 100% dhe është përdorur për shpërblim dajle në pension.

- **Administrimi i pyjeve**

Fondi i planifikuar nga transferta specifike për këtë shërbim ka qenë në vlerën 14,497 mijë lekë, e detajuar si më poshtë:

-Fondi i planifikuar për paga ka qenë në vlerën 10,181 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 7,041 mijë lekë ose në masën 69%.

-Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore ka qenë në vlerën 1,687 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 1,171 mijë lekë ose në masën 69%.

